

Përmbledhje

Sipas vlerësimeve të BQK-së, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje vjetore prej 2.7 përqind, bazuar kryesisht në rritjen e konsumit. Pozicioni i investimeve dhe neto eksportet janë vlerësuar të kenë kontribuar negativisht në rritjen ekonomike. Parashikimet për vitin 2015 tregojnë për një rritje të përsheptuar ekonomike prej 3.5 përqind.

Spektori bankar në mars 2015 është karakterizuar me rritje vjetore të përsheptuar të aktivitetit kreditor prej 4.3 përqind (2.4 përqind në mars 2014). Në anën tjetër, depozitat shënuan rritje më të ngadalshme vjetore prej 5.9 përqind (7.1 përqind në mars 2014), kryesisht si pasojë e rënies së theksuar të normës së interesit në depozita. Normat e interesit në kredi dhe depozita kanë vazhduar rënien edhe gjatë vitit 2015. Mesatarja e normës së interesit në kredi në mars 2015 ishte 8.9 përqind, ndërsa mesatarja e interesit në depozita ishte 0.8 përqind. Spektori bankar i Kosovës u karakterizua me përmirësim të cilësisë së portofolit kreditor, përderisa në mars 2015 pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 8.1 përqind (8.6 përqind në mars 2014). Spektori bankar vazhdon të ketë pozitë të kënaqshme edhe për sa i përket nivelit të kapitalizimit dhe të likuiditetit, të cilat janë përforcuar akoma më shumë në mars 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Spektori fiskal gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Sa i përket të hyrave buxhetore, është

shënuar rritje më e lartë e të hyrave vendore, përderisa në kuadër të shpenzimeve, rritja e kategorisë së pagave e mëditjeve dhe kategorisë së subvencioneve e transfereve ka ndikuar që shpenzimet e përgjithshme qeveritare të shënojnë rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në tremujorin e parë të vitit 2015, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, deficiti në tregtinë e mallrave gjatë kësaj periudhe ka shënuar një përmirësim të lehtë (1.3 përqind), përderisa bilanci pozitiv i shërbimeve dhe të ardhurave parësore u zvogëluan (2.9 përkatësisht 27.5 përqind). Me zvogëlim të bilancit pozitiv u karakterizua edhe llogaria e të ardhurave dytësore (2.7 përqind), rënie që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të transfereve qeveritare ndërkohë që remitencat kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Deri në mars 2015, eksportet shënuan rritje prej 13.5 përqind, përderisa importet u karakterizuan me rritje prej 0.9 përqind. Aktiviteti ekonomik në tremujorin e parë të vitit 2015 rezultoi të jetë mbështetur nga dy burime të rëndësishme të rritjes ekonomike në vend, remitencat dhe IHD-të.

Çmimet kanë vazhduar të shënojnë rënie. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, norma mesatare e deflacionit ishte 0.4 përqind (0.2 përqind inflacioni në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar).

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	04
Ekonomia e Kosovës	07
Sektori Real	07
Sektori Fiskal	09
Sistemi Financiar	11
Sektori Bankar	11
Fondet Pensionale	20
Institucionet Mikrofinanciare	21
Kompanitë e Sigurimit	23
Tregu i Letrave me Vlerë	24
Sektori i Jashtëm	25
GRAFIKËT DHE TABELAT	04
Figura 1. Norma e kreditimit ndër bankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	04
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	06
Figura 3. Çmimi i arit	06
Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 5. Norma e këmbimit e euros	06
Figura 6. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje	07
Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve	08
Figura 9. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	08
Figura 10. Regjistri i bizneseve	09
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 12. Asetet e sistemit financiar në Kosovë	11
Figura 13. Asetet e bankave komerciale	11
Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	12
Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive të reja	12
Figura 16. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	13
Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	13
Figura 18. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik	14
Figura 19. Struktura e maturimit të kredive	14

Figura 20. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale	15
Figura 21. Struktura e depozitave në bankat komerciale	16
Figura 22. Struktura e depozitave sipas maturimit	16
Figura 23. Struktura e depozitave të afatizuara	16
Figura 24. Mesatarja e normave të interesit	17
Figura 25. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndermarrjeve	17
Figura 26. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare	18
Figura 27. Normat mesatare të interesit për depozita	18
Figura 28. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale	19
Figura 29. Treguesit e profitabilitetit	19
Figura 30. NPL-të dhe provizionet për humbje nga kreditë	20
Figura 31. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese	20
Figura 32. Asetet e fondeve pensionale dhe rritja vjetore	20
Figura 33. Asetet e institucioneve mikrofinanciare	21
Figura 34. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit	21
Figura 35. Mesatarja e normave të interesit në kredi të institucioneve mikrofinanciare	22
Figura 36. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë	22
Figura 37. Norma e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit	24
Figura 38. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	25
Figura 39. Remitencat	26
Figura 40. Struktura e investimeve të huaja direkte	26
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	28

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërformuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook


Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, eurozona u karakterizua me një ritëm të shpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik, duke tejkaluar rrezikun e recesionit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në tremujorin e parë të vitit 2015, ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 1.0 përqind. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.4 përqind. Rritja e aktivitetit ekonomik në tremujorin e parë të vitit 2015 ishte e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, veçanërisht në Gjermani, Itali Spanjë dhe Francë. Aktiviteti ekonomik është mbështetur kryesisht nga sektori i prodhimit dhe shërbimeve, që u karakterizuan me rritje gjatë tremujorit të parë të vitit 2015. Sinjalet për përforsim të aktivitetit në eurozonës gjatë vitit 2015 mbështeten kryesisht në çmimet e ulëta të naftës në tregjet ndërkombëtare, gjë që pritet të reflektohet në rritje të besueshmërisë së konsumatorëve dhe rrjedhimisht të kërkesës së brendshme. Gjithashtu, rritja e aktivitetit ekonomik pritet të mbështetet nga rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës, si rezultat i zhvlerësimit të euros, si dhe nga pakoja e masave të reja të lehtësimit sasior që ka ndërmarr Banka Qendrore Evropiane (BQE) që nga muaji mars 2015.

Sipas BQE-së, në mars 2015, eurozona u karakterizua me normë deflacioni prej 0.1 përqind, krahasuar me deflacionin prej 0.3 përkatësisht 0.6 përqind sa ishte në muajin shkurt përkatësisht janar. Të dhënat fillestare sugjerojnë se shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të mbetet tejte e ulët apo edhe

negative në muajt në vijim, përderisa në fund të vitit 2015 pritet ngritje graduale e shkallës së inflacionit. Për vitin 2015 në tërësi, FMN ka parashikuar një normë të inflacionit prej 0.1 përqind. Rritja graduale e shkallës së inflacionit pritet të nxitet kryesisht nga ndikimi i politikave lehtësuese monetare në kërkesën e përgjithshme në eurozonë, ndikimi i normës së ulët të këmbimit të euros, si dhe pritet për rritje graduale të çmimeve të naftës.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)

Në mars 2015, BQE filloi programin e lehtësimit sasior, program nën të cilin pritet të realizojë blerje të obligacioneve të qeverive evropiane dhe letrave të tjera me vlerë të institucioneve evropiane në shumën prej 60 miliard euro në muaj. Emetimi i parasë së re në ekonominë evropiane ka kryesisht synim evitimin e deflacionit dhe rikthimin e normës së inflacionit afër caktit të BQE-së, duke stimuluar kreditimin bankar për bizneset dhe ripërtëritë ekonominë evropiane. Në implementimin e programit të propozuar të Bankës Qendrore Evropiane për lehtësimin sasior fillimisht ishin diskutuar si rreziqe të mundshme pamjaftueshmëria potenciale e obligacioneve qeveritare në dispozicion për të përmbushur zotimin

për blerje në vlerë prej 60 miliardë euro në muaj, si dhe rreziku që mund të vijë nga ndërmarrja e rritur e rrezikut nga investitorët, duke rrezikuar kështu stabilitetin financiar si pasojë e rënies së mëtejme të normave të interesit. Megjithatë, në muajt e parë të lansimit të këtij programi, është vënë re një rikuperim i ekonomisë së eurozonës, përderisa zyrtarët e lartë të BQE-së kanë deklaruar se politikat e lehtësuara monetare do të plotësohen edhe me politika të planifikuara makro-prudenciale për të siguruar mirëmbajtjen e stabilitetit financiar.

Në mars 2015, BQE mbajti të pandryshuar normën bazë të rifinancimit. Megjithatë, pritjet për lasimin e programit të gjerë stimulues që nga janari 2015 dhe lansimi i tij nga marsi i këtij viti kanë ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 3 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në mars 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.010 përqind nga 0.023 përqind në dhjetor 2014. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.212 përqind në mars 2015, nga mesatarja prej 0.329 përqind në dhjetor 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në tremujorin e parë të vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Në kuadër të vendeve ballkanike, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi u karakterizuan me rritje të aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe, të mbështetur kryesisht nga sektori i ndërtimit, prodhimi industrial dhe investimet. Ngjashëm me vitin 2014, Serbia vazhdoi të karakterizohet me tkurrje të aktivitetit ekonomik, kryesisht si pasojë e rënies së konsumit

privat dhe investimeve. Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor presin të shënojnë një rritje mesatare të PBB-së prej 2.8 përqind në vitin 2015. Mali i Zi pritët të karakterizohet me normën më të lartë të rritjes ekonomike prej 4.7 përqind, përderisa Serbia pritët të jetë vendi i vetëm që do shënoj një rënie ekonomike prej 0.5 përqind.


Vendet e Ballkanit Perëndimor në muajt e parë të vitit 2015 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe energjisë në nivel global. Me përjashtim të Shqipërisë dhe Serbisë, që u karakterizuan me një shkallë mesatare të inflacionit prej 1.8 përkatësisht 0.5 përqind në tremujorin e parë të vitit 2015, të gjitha vendet e tjera të rajonit shënuan deflacion. Maqedonia u karakterizua me shkallën më të lartë të deflacionit në tremujorin e parë të vitit 2015 (1.3 përqind), pasuar nga Bosnja e Hercegovina (0.8 përqind), Kosova (0.4 përqind) dhe Mali i Zi (0.3 përqind).

Çmimi ndërkombëtar i naftës

Çmimi i naftës (brent crude)¹ në tremujorin e parë të vitit 2015 shënoj rënie vjetore prej rreth 50.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia më e madhe e çmimit të naftës është shënuar në janar 2015, ndërkohë që muajt në vazhdim janë karakterizuar me ngritje të lehtë të çmimit të naftës (figura 2).

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.


Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD për barel



Burimi: Banka Botrore (2015)

Me rënie të çmimit gjatë tremujorit të parë u karakterizuan edhe metalet e arit (figura 3). Çmimi i arit ishte për rreth 5.8 përqind më i ulët krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014. Rënia më e madhe e çmimit të arit është shënuar në muajin mars 2015, ku 1 njësi ari (njësia matëse ekuivalente me 31.1 gram ari quhet “troy oz”) kanë kushtuar rreth 11.8 përqind më lirë se sa në muajin mars 2014.

Figura 3. Çmimi i arit, në USD për troy oz




Burimi: Banka Botrore (2015)

Trendi i rënies së çmimeve të ushqimit ka vazhduar edhe në tremujorin e parë të vitit 2015. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, indeksi i çmimeve

të ushqimit shënoi rënie prej mesatarisht 15.4 përqind, përderisa indeksi i çmimeve të drithërave shënoi rënie për mesatarisht 13.4 përqind (figura 4).


Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithërave



Burimi: FAO (2015)

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014 është zhvlerësuar. Zhvlerësimin më të madh euro e ka shënuar ndaj dollarit amerikan me 17.7 përqind, pasuar nga frangu zviceran me 12.4 përqind dhe sterlina britanike me 10.2 përqind.

Figura 5. Norma e këmbimit të euros



Burimi: BQK (2014)


Ndaj lekut shqiptar dhe denarit maqedonas euro ka shënuar zhvlerësim të lehtë gjatë tremujorit të parë 2015 (0.2 përkatësisht 0.1 përqind), ndërsa ndaj dinarit serb ka shënuar vlerësim prej 5.0 përqind (figura 5).

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së ishte 2.7 përqind (figura 6). Rritja ekonomike për vitin 2014 bazohet kryesisht në vlerësimet për rritjen e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht. Për vitin 2015, pritet që ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, e cila pritet të arrijë në 3.5 përqind. Ky përshpejtim i rritjes ekonomike pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe investimet.

Figura 6. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



* Të dhënat për vitin 2014 dhe 2015 paraqesin vlerësimet dhe parashikimet e BQK-së
Burimi: ASK (2015)

Të dhënat deri në mars 2015 paraqesin një rritje më të lartë të konsumit, i cili është ndikuar nga rritja e kredive konsumuese, rritja e kategorisë së pagave dhe

mëditjeve qeveritare si rrjedhojë e rritjes së pagave prej 25 përqind në prill të vitit të kaluar, pastaj subvencioneve dhe transfereve, etj. Gjithashtu, rritjen e konsumit e kanë përkrahur edhe remitencat, të cilat në tremujorin e parë të vitit 2015 kanë shënuar rritje vjetore prej 21.7 përqind.

Në anën tjetër, investimet publike deri në mars të vitit 2015 kanë shënuar rënie prej 20.2 përqind, ndërkohë që investimet e huaja direkte (IHD) kanë shënuar rritje për 103.8 përqind. Aktiviteti i sektorit privat është përkrahur edhe nga kreditë e sistemit bankar për ndërmarrjet të cilat në tremujorin e parë të vitit 2015 kanë shënuar rritje prej 2.9 përqind.

Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Niveli i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 është karakterizuar me deflacion prej 0.4 përqind krahasuar me inflacionin prej 0.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 7).

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, komponentët e CPI-së si rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse shënuan rritje të çmimit për 5.3 përqind, pijet

alkoolike dhe duhani 2.6 përqind dhe veshmbathja 2.0 përqind. Me rritje prej 1.5 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit dhe pijet joalkoolike të cilat përfaqësojnë rreth 40.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, përderisa në tremujorin e parë të vitit 2014 çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike patën shënuar rënie prej 1.4 përqind (figura 8). Në anën tjetër, rënie me e theksuar e çmimeve u evidentua tek shërbimet e arsimit për 28.0 përqind, shërbimet e transportit për 9.2 përqind dhe restorantet dhe hotelet për 3.2 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të vitit të kaluar të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universitetit publik, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet kryesisht rënies së çmimit të derivateve të naftës.


Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2015)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 9).

Figura 9. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)


Çmimet e importit² në vitin 2014 shënuan rënie mesatare prej 0.5 përqind (0.2 përqind rritje në vitin 2013). Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë me 24.1 përkatësisht 17.0 përqind, pasuar nga metalet bazë me 12.1 përqind, ndërsa çmimet e tekstilit kanë shënuar rënien më të lartë të çmimeve me 24.0 përqind pasuar nga mjetet e transportit me 7.4 përqind, produktet minerale me 6.9 përqind dhe artikujt ushqimor me 6.7 përqind rënie.

Indeksi i çmimeve të prodhimit në vitin 2014 shënoi rritje mesatare vjetore prej 1.6 përqind ndërkohë që në vitin paraprak kishte shënuar rritje prej 2.4 përqind. Rritja e çmimeve ishte më e theksuar te prodhimi i produkteve kimike me 39.9 përqind dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të tij me 12.9 përqind. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të prodhimit më së shumti ishte evidente te prodhimi i pajisjeve elektrike me 17.1 përqind, pasuar nga nxjerrja e xehes së metalit me 15.2 përqind, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës me 10.2 përqind.

² Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të importit për tremujorin e parë të vitit 2015 do të publikohet me 16 qershor 2015 ndërsa dy ditë më vonë do të publikohet indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin e parë të vitit 2015.

Rënia e çmimeve në industrinë nxjerrëse dhe rritja e tyre në industrinë përpunuese është kryesisht rezultat i lëvizjeve në treg. Indeksi i qarkullimit industrial,³ i cili paraqet ecurinë në treg, për industrinë rrjedhëse ka shënuar rënie mesatare prej 8.4 përqind në vitin 2014 ndërkohë që indeksi i qarkullimit industrial për industrinë përpunuese është rritur për 7.3 përqind.

Figura 10. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2015)

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve është shënuar rënie e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara si dhe rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në tremujorin e parë të vitit 2015 ishte 2,582 që është për 329 ndërmarrje më pak se sa në tremujorin e parë të vitit 2014, ndërsa u mbyllën 501 ndërmarrje apo 65 ndërmarrje më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 10).

Edhe në tremujorin e parë të vitit 2015 dominuan ndërmarrjet e regjistruara në tregti me 784 ndërmarrje të reja, prodhimitari me 276 ndërmarrje, bujqësi me 255 ndërmarrje dhe hoteleri me 253

ndërmarrje (figura 11). Pothuajse të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë është shënuar rënie e numrit të bizneseve të regjistruara me përjashtim të bujqësisë dhe ndërmarrjeve me aktivitet të informacionit dhe komunikimit të cilat kanë shënuar rritje prej 50 përkatësisht 24 ndërmarrje më shumë se sa në tremujorin e parë të vitit 2014.

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2015)

Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore⁴ në tremujorin e parë të vitit 2015 arritën vlerën bruto prej 293.2 milionë euro. Nëse përjashtohen 7.6 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 285.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.7 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet primare buxhetore⁵ arritën vlerën prej 299.3 milionë euro që paraqet rritje prej 17.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rrjedhimisht,

⁴ Në kuadër të të hyrave primare nuk janë përfshirë të hyrat nga huamarrjet, pranimet nga grantet e përgjithshme të donatorëve dhe pranimet e depozitave.

⁵ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe kthimet nga fondet e depozitave.

³ Publikimi "Statistikat Afatshkurtra të Industrisë" për mars 2015 do të publikohet me 29 qershor 2015

gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej rreth 13.7 milionë euro krahasuar me suficitin primar prej rreth 17.9 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2014.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura nga tatimet vendore të cilat arritën vlerën bruto prej 84.0 milionë euro. Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 6.9 milionë euro, atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore shënuan rritje prej 16.7 përqind dhe arritën vlerën prej 77.0 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet kufitare arritën vlerën bruto prej 167.2 milionë euro që janë për 1.4 përqind më të larta se sa në tremujorin e parë të vitit 2014. Të hyrat kufitare neto, të cilat përjashtojnë kthimet e doganës prej 0.6 milionë euro arritën vlerën prej 166.6 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 10.3 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 3.4 përqind. Në anën tjetër, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rënie për 3.2 përqind duke arritur vlerën prej 23.2 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimet shënuan rënie. Investimet kapitale, të cilat në tremujorin e parë të vitit 2015 përfaqësuan rreth 10.7 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan vlerën prej 31.9 milionë euro që paraqet rënie prej 20.2 përqind. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 11.8 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 34.4 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje

prej 20.5 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 126.5 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 30.4 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 92.6 milionë euro. Rritja e këtyre dy kategorive në krahasim me vitin e kaluar i atribuohet faktit se vendimi qeverisë për rritjen e pagave dhe pensioneve i vitit të kaluar ka filluar të zbatohet pas tremujorit të parë të vitit 2014.


Në tremujorin e parë të vitit 2015, vërehet një ekzekutim më i mirë i shpenzimeve të planifikuara (17.3 përqind e planit vjetor) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 (15.8 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel më të mirë të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan në masën prej 6.9 përqind të planit vjetor krahasuar me shkallën prej 7.8 përqind të realizimit në tremujorin e parë të vitit 2014. Në anën tjetër, realizimi i të hyrave buxhetore arriti nivelin prej 18.1 përqind të planit për vitin 2015, që është nivel i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Borxhi publik, në mars 2015, ka arritur në 622.1 milionë euro nga 582.9 milionë euro sa ishte në fund të vitit 2014, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 10.7 përqind nga 10.6 përqind sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje prej 6.7 përqind e borxhit publik, i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm ndërkohë që borxhi i jashtëm ka mbetur pothuajse i pandryshuar.

Sistemi Financiar

Në mars 2015, vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.69 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.1 përqind. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së asetëve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale, sektorë këta që dominojnë asetet e sistemit financiar. Sektori i sigurimeve, ai mikrofinanciar, dhe i ndihmësve financiar, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishin kontribut të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit (figura 12).

Figura 12. Asetet e sistemit financiar të Kosovës, në përqindje (mars 2015)




Burimi: BQK (2015)

Sektori Bankar

Asetet

Vlera e gjithsej asetëve të sektorit bankar në mars 2015 arriti në 3.25 miliardë euro që përkon me një rritje vjetore prej 6.5 përqind (figura 13). Rritja ishte më e ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes të depozitave, që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar.

Figura 13. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Struktura e asetëve të sektorit bankar, në mars 2015 ishte e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Me rritje të pjesëmarrjes u karakterizuan kategoritë e bilancit me bankat tjera dhe parasë së gatshme dhe bilancit me BQK, ndërsa me rënie të lehtë të pjesëmarrjes në gjithsej asetet u karakterizuan kategoria e kredive dhe ajo e letrave me vlerë. Rritja e pjesëmarrjes së kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK krahasuar me vitin e kaluar ishte kryesisht reflektim i ngadalësimit të rritjes së letrave me vlerë dhe të bilancit me bankat tjera, që u reflektua edhe në investimet e sektorit bankar në sektorin e jashtëm në këto dy instrumente.

Kategoria e bilancit me bankat tjera u karakterizua me rritje vjetore prej 15.6 përqind, e cila është dukshëm më e ulët se sa rritja prej 42.5 përqind në mars 2014, kryesisht si pasojë e rritjes më të ulët të depozitave të afatizuara të mbajtura në bankat jashtë vendit gjatë kësaj periudhe. Investimet në letra me vlerë, në mars 2015 arritën vlerën prej 400.7 milionë, duke shënuar rritje vjetore prej 2.1 përqind, që është dukshëm më e ulët se rritja prej 42.5 përqind e vitit paraprak. Ky zhvillim ishte kryesisht si rezultat i rënies vjetore prej 23.3 përqind (ritje 31.6 përqind në

mars 2014) të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, të cilat edhe përbëjnë 50.9 të portfolios së investimeve. Normat e pafavorshme të interesit në letrat me vlerë të qeverive të huaja kanë ndikuar që bankat të zvogëlojnë investimet jashtë vendit në këtë instrument. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në mars 2015 përbënë 49.0 përqind të gjithsej portfolios së investimeve në letra me vlerë dhe shënuan rritje vjetore prej 54.4 përqind. Nga kjo shihet se bankat vazhdojnë të favorizojnë investimet në letra me vlerë në tregun vendor, gjë e cila kryesisht reflekton normat më të larta të interesit që ofrojnë këto instrumente të investimeve.

Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Kreditë

Gjatë tremujorit të parë 2015, kreditë vazhduan të përshpejtojnë ritmin e rritjes. Në mars 2015, gjithsej kreditë arritën vlerën 1.90 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.3 përqind (2.4 përqind në mars 2014) (figura 14). Duke arritur vlerën prej 216.3 milionë euro, gjithsej kreditë e reja të lëshuara gjatë

tremujorit të parë 2015 u karakterizuan me rritje vjetore prej 8.4 përqind. (figura 15).

Figura 15. Vlera dhe ndryshimi vjetor i kredive të reja, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Rritja e aktivitetit kreditor, sipas anketës për kreditimin bankar, i atribuohet kryesisht ofertës më të lehtësuar bankare gjatë periudhës shtator 2014 – mars 2015, përderisa kërkesa për kredi vlerësohet të ketë mbetur përgjithësisht e pandryshuar gjatë kësaj periudhe. Bankat deklaruan standarde më të lehtësuara kreditore për ndërmarrjet dhe për kreditë konsumuese gjatë kësaj periudhe. Sa i përket shkallës së aprovimit të kredive, bankat deklaruan të kenë mbajtur një qasje më të lehtësuar përgjithësisht për NVM-të.


Në gjashtë muajt e ardhshëm (mars-shtator 2015), oferta kredituese e bankave, shprehur përmes standardeve të aplikuara kreditore pritet të mbetet përgjithësisht e pandryshuar. Megjithatë, një numër i bankave kanë deklaruar se presin lehtësim te standardeve kreditore për NVM-të, përderisa pothuajse të gjitha bankat deklaruan se presin lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore që do të aplikojnë për ekonomitë familjare (kredi

konsumuese dhe kredi për blerje të shtëpive). Sa i përket shkallës së aprovimit të kredive, bankat presin qe shkalla e aprovimit të kredive në gjashtë muajt e ardhshëm të mbetet përgjithësisht e pandryshuar, megjithëse një qasje më të lehtë në financim bankar pritet të kenë NVM-të dhe ekonomitë familjare.

Për dallim nga gjashtëmujori i kaluar kur kërkesa për kredi ishte përgjithësisht më e ulët, në periudhën mars/shtator 2015, bankat kanë deklaruar se presin një rikuperim të kërkesës për kredi. Kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë nga NVM-të, por edhe nga ndërmarrjet e mëdha. Kërkesë më të lartë bankat presin edhe nga ekonomitë familjare.

Rritja e gjithsej kredive deri në mars 2015 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar prej 10.8 përqind të kredive ndaj ekonomive familjare (3.5 përqind në mars 2014). Me rritje u karakterizuan edhe kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat poashtu u karakterizuan me përsheptim të rritjes në 2.9 përqind në mars 2015 (2.2 përqind në mars 2014) (figura 16).


Figura 16. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për tregti me pjesëmarrje prej 53.2 përqind, pasuar nga prodhimtaria me 12.2 përqind dhe ndërtimtaria me 8.2 përqind. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë çasje më të ulët në financimin bankar, me pjesëmarrje prej 3.9 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (figura 17).


Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (mars 2015)



Burimi: BQK (2015)

Gjatë tremujorit të parë 2015, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi rritje, përjashtuar sektorin e ndërtimitarisë i cili vazhdon të karakterizohet me rënie të kreditimit. Kreditimi i sektorit të bujqësisë u karakterizua me rritjen më të theksuar krahasuar me sektorët tjerë. Kreditë ndaj sektorit të bujqësisë në mars 2015 shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind krahasuar me rënie prej 1.6 përqind në mars 2014. Rritja është rrjedhojë e uljes së theksuar të normave të interesit të ofruara nga bankat dhe njëkohësisht rritjes së theksuar të numrit të bizneseve në këtë sektor.

Figura 18. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2015)

Kreditë për sektorin e tregtisë shënuan rritje vjetore prej 3.7 përqind (1.6 përqind në mars 2014). Rritja e kreditimit ndaj sektorit të tregtisë është nxitur nga rritja e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera dhe rënia e normave të interesit në kredi, gjë që mund të ketë rritur kërkesën për kredi. Rritje shënuan edhe kreditë për sektorin e prodhimit të cilat në mars 2015 shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind. Sektori i ndërtimit ishte i vetmi sektor që vazhdoi të karakterizohet me rënie të kreditimit. Në mars 2015, kreditë ndaj sektorit të ndërtimit shënuan rënie vjetore prej 9.0 përqind (figura 18). Duke marrë për bazë rënien e numtit të ndërmarrjeve të reja të regjistruara në këtë sektor, zvogëlimi i kreditimit mund të reflektojë rënien e aktivitetit në këtë sektor. Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive mbetet kryesisht e ngjashme me vitet paraprake dhe vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (figura 19).

Krahasuar me vitin paraprak, vërehet rënie e pjesëmarrjes së kredive afatshkurtëra (‘deri në 1 vit), përderisa është rritur pjesëmarrja e kredive afatmesme dhe kredive afatgjata (‘mbi 5 vite’).

Figura 19. Struktura e maturimit të kredive



Burimi: BQK (2015)

Rritja e pjesëmarrjes së kredive afatgjata në gjithsej kreditë mund të reflektojë lehtësimin e standardeve kreditore dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave.

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar u karakterizua me ritëm të përshpejtuar të rritjes gjatë tremujorit të parë 2015. Rritjen më të lartë e shënuan kreditë për ekonominë familjare. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, të gjithë sektorët e ekonomisë regjistruan rritje të kreditimit, përveç sektorit të ndërtimit. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit tregon për rritje të pjesëmarrjes së kredive me afat të gjatë maturimi.

Detyrimet

Në mars 2015, struktura e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës vazhdoi të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë mbetet ajo e mjeteve vetanake e cila në mars 2015 shënoi rritje vjetore prej 19.9 përqind (3.9 përqind në mars 2014). Rritja ishte si rezultat i profitit të bartur nga viti i kaluar dhe


profitit të akumuluar gjatë tre muajve të parë të vitit 2015.

Kategoria e cila shënoi rritjen më të lartë në kuadër të detyrimeve ishte bilanci nga bankat tjera që shënoi rritje vjetore prej 35.6 përqind në mars 2015. Ndërsa, borxhi i ndërvarur, në mars 2015 shënoi rënie vjetore prej 16.0 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 81.5 përqind në mars 2014, kryesisht si rezultat i ngritjes së nivelit të kapitalizimit bankar me rritjen e fitimit të akumuluar në vitin 2014 .

Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar në mars 2015 arritën vlerën 2.57 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 5.9 përqind (7.1 përqind në mars 2014) (figura 20).

Figura 20. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Faktori kryesor që mund të ketë ndikuar në ngadalësimin e rritjes së depozitave mund të jetë rënia e theksuar e normës së interesit në depozita që po karakterizon sektorin bankar. Ndikim në ngadalësimin e rritjes së depozitave mund të ketë pasur edhe rritja e emigrimit nga Kosova në muajt e parë të vitit 2015. Struktura e depozitave në sektorin

bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 74.0 përqind të gjithsej depozitave.

Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 20.3 përqind në gjithsej depozitat (figura 21).

Figura 21. Struktura e depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2015)

Në mars 2015 norma vjetore e rritjes së depozitave të ekonomive familjare ishte 6.3 përqind, që është më e ulët se sa rritja në vitin paraprak (7.2 përqind në mars 2014). Ngadalësimi i rritjes përkon me rënien e theksuar të normës së interesit në depozita në mars 2015 krahasuar me mars 2014. Ndërsa, depozitat e ndërmarrjeve kanë përsheptuar ritmin e rritjes duke u rritur për 5.1 përqind në mars 2015 (4.7 përqind në mars 2014). Rritja e depozitave të ndërmarrjeve mund të jetë ndikuar nga rritja e normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve në mars 2015 krahasuar me mars 2014.

Kategoria e depozitave tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare, etj.) shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind në mars 2015 (15.2 përqind në mars 2014).

Struktura e depozitave sipas maturitetit ka ndryshuar krahasuar vitin paraprak kur ajo dominohej nga depozitat e afatizuara. Në mars 2015, pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme, të cilat përbënë 49.2 përqind të gjithsej depozitave.


Figura 22. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Depozitat e afatizuara përbënë 29.1 përqind ndërsa ato të kursimit 21.7 përqind (figura 22).

Figura 23. Struktura e depozitave të afatizuara



Burimi: BQK (2015)

Zvogëlimi i theksuar i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në strukturën e gjithsej depozitave u ndikua nga rënia e theksuar e normave të interesit në

depozita, gjë që mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozituesit.


Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, në periudhën raportuese vihet re rritje në pjesëmarrje të depozitave me afat të gjatë maturimi 'mbi 2 vite' dhe në ato afatmesme 'mbi 1 deri në 2 vite'. Ndërsa depozitat afatshkurta 'deri 1 vit' kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e depozitave të afatizuara. Këto lëvizje jenë ndikuar nga normat e interesit, të cilat janë më të larta në depozitat me afat më të gjatë maturimi krahasuar me normat në depozitat me afat më të shkurtër maturimi (figura 23).

Në mars 2015, depozitat vazhduan të rriten por me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin paraprak. Kapitali vetanak, që përfaqëson kategorinë e dytë më të madhe në kuadër të detyrimeve, shënoi rritje të theksuar në mars 2015 kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar të profitit të sektorit bankar gjatë vitit.

Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita kanë vazhduar rënien edhe gjatë tremujorit të parë 2015.

Figura 24. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Në mars 2015, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 8.9 përqind nga 11.2 përqind në mars

2014. Rënia mund të jetë ndikuar nga presioni i konkurrencës bankare dhe zvogëlimit të kostos së financimit të aktivitetit bankar. Në depozita, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 0.8 përqind nga 1.7 përqind sa ishte në mars 2014. Rënia konsiderohet kryesisht rrjedhojë e prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar.

Në mars 2015, dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita u zvogëlua në 8.1 përqind nga 9.5 përqind sa ishte në mars 2014, si rezultat i rënies më të theksuar të normës së interesit në kredi krahasuar me rënien në depozita (figura 24).

Trendi rënës i normave të interesit në kredi është shprehur si në kreditë ndaj ndërmarrjeve, ashtu edhe në ato ndaj ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në mars 2015 u zvogëlua në 8.9 përqind nga 11.3 përqind sa ishte në mars 2014. Në kuadër të ndërmarrjeve, rënia më e theksuar u shënuar në kreditë investuese me maturim ‘mbi 1 vit’, të cilat në mars 2015 zbritën në 8.3 përqind nga 11.4 përqind në mars 2014 (figura 25).

Figura 25. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Sipas veprimtarisë ekonomike, rënia e normës së interesit ishte më e theksuar në kreditë ndaj sektorit

të bujqësisë dhe shërbimeve. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë u zvogëlua në 11.1 përqind në mars 2015 nga 15.9 përqind në mars 2014, ndërsa për sektorin e shërbimeve u zvogëlua në 9.0 përqind nga 11.0 përqind në mars 2014. Sektori i industrisë vazhdon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi prej 8.7 përqind në mars 2015 (9.8 në mars 2014).

Në mars 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëlua në 8.9 përqind, nga 11.1 përqind sa ishte në mars 2014. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit në kreditë konsumuese shënuan rënien më të madhe, në 9.0 përqind në mars 2015 (11.3 përqind në mars 2014), përderisa norma e interesit për kreditë hipotekare u zvogëlua në 8.2 përqind (9.3 përqind në mars 2014) (figura 26).

Figura 26. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind




Burimi: BQK (2015)

Sa i përket normave të interesit në depozita, vërehet një rënie e theksuar e interesit në depozitat e ekonomive familjare nga 1.7 përqind në mars 2014 në 0.7 përqind në mars 2015 (figura 27). Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve u

rrit në 1.0 përqind në mars 2015 nga 0.5 përqind në mars 2014.

Figura 27. Normat mesatare të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Performanca e sektorit bankar


Profiti i sektorit bankar edhe gjatë tremujorit të parë 2015 shënoi rritje të theksuar krahasuar me vitet paraprake. Neto profiti i realizuar deri në mars 2015 shënoi vlerën 19.9 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 9.8 milionë euro të regjistruar deri në mars 2014. Rritja e profitit është kryesisht rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve, përderisa të hyrat shënuan rritje të lehtë.

Të hyrat e sektorit bankar deri në mars 2015 arritën vlerën 59.7 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 0.4 përqind. Struktura e të hyrave vazhdon të dominohet nga të hyrat nga interesi me 79.2 përqind, pasuar nga të hyrat nga jo-interesi me pjesëmarrje prej 20.1 përqind, dhe pjesa e mbetur nga të hyrat nga rivlerësimi.

Deri në mars 2015, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind. Kjo rënie i atribuohet zvogëlimit të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si

rrjedhojë e rënies së normave të interesit në kredi. Të hyrat nga jo-interesi deri në mars 2015 shënuan rritje vjetore prej 3.1 përqind, dhe kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga jo interesi, të hyrat nga tarifat dhe komisionet dhe të ardhurat tjera operative shënuan rritje vjetore prej 3.3 përqind përkatësisht 0.6 përqind.

Figura 28. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar deri në mars 2015 arriti në 39.7 milionë euro, e cila është për 20.0 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të interesit, që shënuan rënie vjetore prej 53.3 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita shënuan rënie vjetore prej 59.5 përqind, që kryesisht reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita.

Gjithashtu, kontribut në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve kishe edhe reduktimi i shpenzimeve të jo-interesit, të cilat shënuan rënie vjetore prej 37.1 përqind. Në kuadër të tyre, rënien më të madhe

vjetore prej 45.9 përqind shënuan shpenzimet për provizione. Rënia e vlerës së gjithsej kredive jo performuese ka ndikuar në ndarjen më të ulët të provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, shënuan një rritje vjetore prej 2.2 përqind deri në mars 2015.



Për 2015 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në Mars 2015

Burimi: BQK (2015)


Rritja e lehtë e të hyrave dhe zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve ka ndikuar që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar të përmirësohet dukshëm. Në mars 2015, ky indikator u zvogëluar në 66.6 përqind, krahasuar me 83.6 përqind sa ishte deri në mars 2014 (figura 28). Po ashtu, profiti i realizuar deri në mars 2015 ka ndikuar që Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) të përmirësohet në 2.5 përqind, nga 1.9 përqind sa ishte në 2014, përderisa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 23.6 përqind, nga 20.2 përqind sa ishte në 2014 (figura 29).⁶

Profiti i sektorit bankar ka vazhduar të rritet edhe gjatë tremujorit të parë 2015. Zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve, sidomos shpenzimeve të interesit dhe atyre për provizione, paraqesin kontribuesin kryesor në rritjen e gjithsej profitit të sektorit bankar. Në anën tjetër, të hyrat shënuan vetëm një rritje të lehtë.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar i Kosovës vijon të karakterizohet me nivel të ulët të kredive jo performuese dhe nivel të kënaqshëm të mbulueshmërisë së tyre me provizione.

Figura 30. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Në mars 2015, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëluar në 8.1 përqind nga 8.6 përqind sa ishte në mars 2014 (figura 30). Në rënien e normës së NPL-ve mund të ketë ndikuar përsheptimi i rritjes së kreditimit gjatë kësaj periudhe mirëpo edhe rënia vjetore prej 1.2 përqind e vlerës së kredive jo performuese krahasuar me rritjen prej 15.5 përqind të shënuar në mars 2014 (figura 31). Mbulueshmëria me provizione e kredive jo performuese në mars 2015 u përmirësua në 116.4 përqind krahasuar me 114.6 përqind në mars 2014.

⁶ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të analizuar me performancën e sektorit bankar deri në mars 2015.

Figura 31. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të mirë të kapitalizimit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 18.7 përqind në mars 2015 nga 17.4 përqind sa ishte në mars 2014. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet profitit të realizuar nga bankat në vitin 2014 si dhe fitimit të akumuluar gjatë tre muajve të parë të vitit 2015. Sektori bankar vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në mars 2015, raporti i kredive ndaj depozitave ishte 73.9 përqind, kurse raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 44.2 përqind në mars 2015.⁷

Fondet pensionale

Asetet e sektorit pensional në mars 2015 arritën vlerën prej 1.17 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 23.1 përqind (figura 32).


Struktura e aseteve të sektorit të pensioneve vazhdon të jetë e ngjashme me periudhat paraprake. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) menaxhon 99.5 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa pjesa e mbetur

⁷ Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.

prej 0.5 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

Asetet e FKPK-së gjatë tremujorit të parë 2015 kanë vazhduar të rriten si rezultat i arkëtimeve të reja të kontributeve pensionale dhe kthimit pozitiv në investime. Në mars 2015, vlera e gjithsej aseteve të FKPK-së arriti në 1.17 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 23.2 përqind. Deri në mars 2015, FKPK ka realizuar 54.8 milionë euro kthim bruto nga investimet, që paraqet kthimin me vlerën më të lartë të arritur gjatë një tremujori të vetëm. Ndërsa, vlera e kontributeve të arkëtuara deri në mars 2015 arriti në 32.7 milionë euro me rreth 482.0 mijë kontribues.

Figura 32. Asetet e fondeve pensionale dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

Në ditën e fundit të muajit mars 2015, çmimi i aksionit arriti në 1.35 euro (1.22 euro në mars 2014).


Gjithashtu, edhe FSKP-ja u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe performancës gjatë tremujorit të parë 2015. Në mars 2015, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 6.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.6 përqind. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që deri në mars 2015 arriti në 208.3 mijë euro. Në ditën e fundit të marsit 2015,

çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 151.41 euro (140.81 euro në mars 2014).⁸

Institucionet mikrofinanciare (IMF)

Gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar në mars 2015 arritën vlerën prej 113.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.9 përqind krahasuar me rënie prej 1.5 përqind në mars 2014 (figura 33).

Figura 33. Asetet e institucioneve mikrofinanciare dhe rritja vjetore




Burimi: BQK (2015)

Vlera e gjithsej kredive arriti në 75.2 milionë euro në mars 2015, duke shënuar rritje vjetore prej 1.3 përqind (rënie vjetore prej 2.0 përqind në mars 2014). Rritja e gjithsej kredive ishte rezultat i rritjes së kredive për ndërmarrjet, në cilat në mars 2015 ishin për 8.0 përqind më të larta krahasuar me mars 2014. Ndërsa, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rënie vjetore prej 1.8 përqind. Rënia e kreditimit ndaj ekonomive familjare mund të jetë ndikuar nga konkurrenca prej sektorit bankar duke marrë parasysh që kreditimi bankar për ekonomitë familjare gjatë kësaj periudhë ka shënuar rritje të theksuar.

⁸ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

Sipas sektorëve ekonomik, pothuajse të gjitha kategoritë e kreditimit në mars 2015 u karakterizuan me rritje. Kreditë ndaj sektorit të shërbimeve të cilat përbëjnë 45.8 përqind të gjithsej strukturës, u karakterizuan me rritje vjetore prej 5.8 përqind (rënie vjetore prej 1.7 përqind në mars 2014). Kreditë ndaj sektorit të industrisë, të cilat janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturë, shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 16.7 përqind në mars 2015 krahasuar me rënie vjetore prej 6.0 përqind në mars 2014. Në kuadër të sektorit të industrisë, kreditë për ndërtimtari u karakterizuan me rritje vjetore prej 14.3 përqind në mars 2015, për dallim nga sektori bankar, ku kreditimit i kësaj veprimtarie vazhdon të zvogëlohet. Me rritje u karakterizua edhe kategoria e tretë për nga madhësia që përbëhet nga kreditë ndaj bujqësisë, të cilat shënuan rritje vjetore prej 3.1 përqind në mars 2015 (rënie prej 14.9 përqind në mars 2014).

Figura 34. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Struktura e kredive të IMF-ve sipas afatit të maturimit vazhdon të jetë e ngjashme me vitet e kaluara, duke u dominuar nga kreditë me afat të mesëm maturimi. Në mars 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri 5 vite' në mars 2015 kishin një

pjesëmarrje prej 85.5 përqind në gjithsej kreditë, pasuar nga ato me maturim 'deri 1 vit' me 14.2 përqind dhe 'mbi 5 vite' me 0.3 përqind (figura 34).

Vlera e lizingjeve në mars 2015 arriti në 22.8 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 2.3 përqind. Lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore prej 78.7 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së lizingut hipotekar. Ndërsa, lizingjet për ndërmarrje shënuan rënie vjetore prej 31.2 përqind në mars 2015 kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të lizingut financiar – kredive hipotekare, dhe lizingut për blerjen e pajisjeve.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues të IMF-ve u mbështet nga rritja e huazimeve prej sektorit të jashtëm, që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të këtij sektori. Në mars 2015, huazimet e IMF-ve arritën vlerën prej 82.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.5 përqind (rënie prej 2.1 përqind në mars 2014).


Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel relativisht të ulët të kredive jo performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kësaj kategorie të kredive. Në mars 2015, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u përmirësua në 5.2 përqind, në krahasim me normën prej 5.8 përqind sa ishte në mars 2014. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione u përmirësua në 114.4 përqind në mars 2015 krahasuar me nivelin prej 106.3 përqind në mars 2014.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me norma më të larta të interesit në kredi, në krahasim

me normat që ofrohen nga sektori bankar. Mesatarja e normës efektive të interesit në kreditë e lëshuara nga IMF-të në mars 2015 ishte 24.1 përqind (24.1 përqind në mars 2014).

Mesatarja e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare në mars 2015 ishte 24.5 përqind, që paraqet nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në mars 2015 ishte 23.2 përqind krahasuar me mesataren prej 18.4 përqind sa ishte në mars 2014 (figura 35).

Figura 35. Mesatarja e normave të interesit në kredi të institucioneve mikrofinanciare, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe industrisë në mars 2015 u zvogëlua në 24.9 përqind përkatësisht 23.9 përqind (26.0 përqind përkatësisht 24.3 përqind në mars 2014). Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve u rrit në 23.6 përqind nga 22.2 përqind në mars 2014. Zvogëlimi i normave të interesit për sektorin e bujqësisë dhe industrisë mund të ketë pasur efekt pozitiv në rritjen e kreditimit për këto dy

kategori në mars 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Spektori mikrofinanciar deri në mars 2015, regjistroi profit neto prej 359.8 mijë euro kundrejt humbjeve prej 243.1 mijë euro të shënuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Performanca pozitive financiare ishte rrjedhojë e rritjes së të hyrave krahas zvogëlimit të shpenzimeve.

Në mars 2015, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra në vlerë prej 4.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore të konsiderueshme prej 6.0 përqind krahasuar me rënien prej 12.1 përqind të shënuar në mars 2014. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 4.6 milionë euro në mars 2015 duke shënuar rënie vjetore prej 6.6 përqind. Rënia ishte kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë.

Rrjedhimisht, Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) u përmirësua në 1.3 përqind (1.1 përqind në vitin 2014), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 4.6 përqind (4.3 përqind në vitin 2014).⁹

Kompanitë e sigurimit

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në mars 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind, duke arritur vlerën 141.9 milionë euro. Në kuadër të gjithsej asetëve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 127.4 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 14.5 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 21.4 milionë euro, që paraqet një rritje

vjetore prej 16.0 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 20.7 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë 0.6 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në mars 2015 arriti në 8.2 milionë¹⁰ euro, prej të cilave 5.6 milionë euro janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Deri në mars 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 246.0 mijë euro, krahasuar me humbjet prej 73.8 mijë euro të vitit paraprak. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahas performancës pozitive financiare të sigurimit jetë. Deri në mars 2015, sigurimi jo-jetë kishte humbje prej 371.7 mijë euro krahasuar me humbjet prej 347.8 mijë euro gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Kurse, sigurimi jetë regjistroi profit në vlerë prej 125.7 mijë euro nga 274.0 mijë euro deri në mars 2014.

Operimi me humbje i sektorit të sigurimeve ndikoi në përkeqësimin e indikatorëve të profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përkeqësua në -0.7 përqind (-0.2 përqind në vitin 2014) kurse ROAE në -2.1 përqind (-0.7 përqind në vitin 2014).¹¹

Spektori pensional vazhdoi të ketë performancë të mirë financiare dhe zgjerim të aktivitetit. Deri në mars 2015, sektori pensional shënoi rritje rekorde të kthimit bruto nga investimet. Spektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe rritje të fitimit

⁹ ROAA dhe ROAE për vitin 2015 janë të aktualizuara me performancën e sektorit deri në mars 2015.

¹⁰ Duke përjashtuar dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit.


¹¹ ROAA dhe ROAE të aktualizuara me performancën e sektorit deri në Mars 2015

neto gjatë kësaj periudhe. Kurse, sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit, mirëpo u karakterizua me dobësim të performancës financiare.

Tregu i letrave me vlerë

Gjatë periudhës janar-mars 2015, shuma e letrave me vlerë të emetuara të Qeverisë së Kosovë arriti në 100 milionë euro krahasuar me vlerën prej 116.4 milionë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie u ndikua prej ofertës së zvogëluar nga Qeveria e Kosovës, e cila zvogëloi shumën e letrave me vlerë të emetuara, më konkretisht ato me maturim prej 91 dhe 182 ditësh.

Figura 36. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Deri në mars 2015, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka pasur gjithsej 5 ankande. Prej të cilave, 1 me afat maturimi 91 ditë, 1 me afat maturimi 182 ditë, 2 me afat maturimi 364 ditë, si dhe 1 ankand me afat maturimi dy vjeçar. Krahasuar me vitet e kaluara, kemi një orientim më të madh drejtë emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimi (figura 36).

Kjo zhvendosje, u ndikua nga ana e ofertës dhe normave të interesit më të larta në instrumentet afatgjata.

Që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë në vitin 2012, shuma e ofertuar vazhdimisht ka tejkaluar shumën e shpallur në ankande prej Departamentit të Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në mars 2015, raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankande ishte 1.9 herë më i lartë që është raport i ngjashëm në mars 2014. Rritja e përshpejtuar e kreditimit bankar gjatë tremujorit të parë 2015 si dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave mund të kenë ndikuar që kërkesa për letra me vlerë nga bankat të mos shënojë rritje të mëtutjeshme. Ndikim të ngjashëm mund të ketë pasur edhe zhvendosja e një pjese të konsiderueshme të mjeteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga BQK-ja në sektorin e jashtëm.

Figura 37. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në periudhën janar-mars 2015 ishte më e lartë (1.8 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (1.2 përqind). Zhvendosja e emetimit të letrave drejt atyre me maturim afatgjatë ka ndikuar

që norma mesatare e interesit gjatë kësaj periudhe të jetë më e lartë krahasuar me periudhën paraprake (figura 37).

Sektori i Jashtëm


Në tremujorin e parë të vitit 2015, deficitin në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale kishte vlerën 50.0 milionë euro, që tregon për një rritje krahasuar me deficitin prej 34.3 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përkeqësimi i bilancit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në tremujorin e parë të vitit 2015 kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë rrjedhëse gjatë kësaj periudhe. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, deficitin në tregtinë e mallrave ka shënuar një përmirësim të lehtë prej 1.3 përqind, përderisa llogaria e shërbimeve dhe të ardhurave parësore u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv prej 2.9 përkatësisht 27.5 përqind krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Gjithashtu, bilanci pozitiv i llogarisë së të ardhurave dytësore ishte më ulët për 2.7 përqind, i cili kryesisht i atribuohet zvogëlimit të transfereve qeveritare ndërkohë që remitencat kanë shënuar rritje të konsiderueshme.

Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 386.6 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2015, që paraqet një rënie prej 1.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 38).

Gjithsej eksportet në mars 2015 arritën vlerën 74.7 milionë euro, që përkon me një normë vjetore të rritjes prej 13.5 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të metaleve bazë, si kategoria me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të

vendit, rritjes së eksporteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksporteve të produkteve ushqimore.

Figura 38. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2015)


Në mars 2015, sasia e mallrave të eksportuara u karakterizua me një rritje vjetore prej 16 përqind, për dallim nga rënia vjetore prej 4 përqind me të cilën ishin karakterizuar në vitin paraprak.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, në mars 2015, arriti në 461.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 0.9 përqind. Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, produktet ushqimore, kategoria e mjeteve të transportit, etj. Si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së eksporteve në shkurt 2015, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 16.2 përqind, nga 14.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga

të ardhurat e punonjësve Kosovar jashtë vendit.¹² Në tremujorin e parë të vitit 2015, të hyrat nga kompenzimi i punonjësve arritën vlerën prej 53.7 milionë euro, një rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 11.6 përqind.

Figura 39. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vetëm në tremujorin e parë të vitit 2015, vlera e remitencave të pranuar në Kosovë arriti vlerën prej 159.3 milionë euro, një rritje prej 21.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në tremujorin e parë të vitit 2015, vlera e IHD-ve u karakterizua me rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. IHD-të arritën vlerën prej 87.1 milionë euro, një rritje krahasuar me vlerën prej 42.7 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizuan të dy kategoritë,

kapitali dhe fondi i investimeve në aksione dhe investimet në instrumentet e borxhit.

Figura 40. Strukturat e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Sektorët që përfituan më shumë nga rritja e IHD-ve ishin sektori i patundshmërive, qiradhënies dhe aktiviteteve tjera biznesore, si dhe sektori i shërbimeve financiare.

¹² Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.